

094. 916. psecat.

dt. 19.02.18.



World Vision

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

### PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT " TUNGJATJETA... JETË"

Për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuar, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve me katër lloje specialitetesh (punonjës social, psikolog, fizioterapist dhe logopedist)

<b>Nr. Marreëveshjes:</b>	I (një)
<b>Titulli i projektit:</b>	"Tungjatjeta... Jetë"
<b>Sponsorizuesi:</b>	World Vision Albania
<b>Institucioni zbatues:</b>	BASHKIA LIBRAZHDI
<b>Periudha e buxhetit:</b>	01.04.2018 – 30.03.2019 (nje vit)
<b>Kontributi i World Vision Albania:</b>	3.360.960 Lekë (Tre milion e treqind e gjashtedhete e nenteqind e gjashtedhete mije lekë)

E lidhur sot në datë **16 / 02 / 2018**, mbështetur në vullnetin e lirë të palëve, bazuar në Ligjin.nr139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Kodit Civil të RSH dhe Ligjit nr.7892 datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet" i ndryshuar, Ligji nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr.597, datë 22.12.2017 "Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencës shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuara", ndërmjet:

World Vision Albania, një organizatë ndërkombëtare joqeveritare, me regjistrim gjykatë 2544 më 09/09/1999, NIPT J92127018B, me zyrën e saj shqiptare të vendosur në Rr. "Skenderbej", Kompleksi "Gurten", Kati 2, Tiranë, dhe adresë postare: Kutia Postare 1725, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Drejtor Ekzekutiv Znj. Eljona Elmazi .

DHE

Bashkisë Librazhd e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Kastriot Gurra;

Per keto arsye; Bashkia Librazhd dhe World Vision Albania rane dakord të bashkëpunojnë për realizimin e projektit "Tungjatjeta... Jete". Bashkia merr përsipër të miratojë në Këshillin Bashkiak, shtimin e ekipit levizes si pjesë të strukturës së saj. World Vizion Albania merr përsipër të kalojë fondin e nevojshem tek dega e thesarit të Bashkisë Librazhd specifikisht për pagat e katër specialistëve të ekipit levizes, përfshitë kontributin e sigurimeve shoqërore shëndetësore të parashikuara në Kodin e Punës.



## Neni 1: Objekti i marrëveshjes

Objekt i kësaj kontrate është sponsorizimi në vlerën **3.360.960 Lekë**, nga ana e World Vision Albania për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencës shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuar sipas projektit "Tungjatjeta... Jetë", për të kryer pagesën (paga bruta e punëmarrësit dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, detyrim i punëdhënësit) për katër profesionistëve me kohë të plotë, një punonjës social, një psikolog, një logopedist dhe një fizioterapist, pjesë e ekipit lëvizës komunitar që ofrojnë asistencë në familje për fëmijët me aftësi të kufizuar.

## Neni 2 : Përshkrim i shkurtër i projektit " Tungjatjeta... Jetë "

Modeli i ndërhyrjes "Tungjatjeta... Jetë " është model ndërhyrje i cili ofron shërbime në shtëpi nëpërmjet specialistëve dhe shërbimi i mobilizimit të komunitetit për të krijuar një kulturë mbështetëse ndaj familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar.

Me shërbimet në shtëpi nënkuptohet që një njësi levizëse do të krijohet dhe do të pajiset me aftësi dhe infrastrukturë të nevojshme (automjet, materiale ndihme) për të ofruar shërbime cilësore për fëmijet me aftësi të kufizuar në familje. Kjo njësi levizëse do të përbëhet nga një ekip profesionistësh: punonjës socialë, psikologë, fizioterapist dhe logopedist . Ekipi do të vlerësojë nevojat e fëmijës dhe familjes dhe do të zhvillojë një Plan Zhvillimi Individual (PZHI) dhe do të kryejë vizita/terapi në familje sipas planit të përcaktuar në PZHI. Ky ekip specialistësh në të njëjtën kohë do të mbështesë anëtarët e familjes / kujdestarët duke synuar aftësimin e tyre në realizimin e aktiviteteve që ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e tyre. Familjet gjithashtu do të pajisen sipas nevojës me pajisje ndihmëse si: karrige me rrota; pajisjet ortopedike; këpucë të përshtatura ortopedike për fëmijët me vështirësi në lëvizje ; pajisje dëgjimi; syze; pelenat etj. Në situata emergjente, shkaktuar nga kushtet e vështira atmosferike, " Tungjatjeta...Jetë" do të ofrojë paketa emergjente si dru, batanije, paketa ushqimore, etj për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuar pjese e projektit.

Komponenti i dytë kyç i modelit "Tungjatjeta... Jetë " është mobilizimi i komunitetit. Duke punuar ngushtë me komunitetin , familjen , strukturat , aktore të interesuara dhe profesionistët projekti synon të fuqizojë sistemin mbështetës me bazë në komunitet për familjet dhe fëmijët me aftësi të kufizuar. Ky sistem mbështetës komunitar do të promovohet dhe fuqizohet përmes krijimit të një grupi vullnetarësh të cilët do të bashkëpunojnë dhe asistojnë familjen përfshi vëllëzërit dhe motrat e këtyre fëmijëve me aktivitete ndërgjegjësuese dhe të natyrës psiko-sociale. Referojuni për më shumë Aneksin I .

### **Objektivat e projektit janë si më poshtë:**

1. Shërbimi Lëvizës Komunitar, i themeluar dhe i pajisur me aftësi dhe infrastrukturë të nevojshme për të ofruar shërbime cilësore për fëmijet me aftësi të kufizuar.
2. Shërbimi lëvizës është funksional dhe ofron shërbime mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre në mjedisin e tyre familjar.
3. Komunitet mbështetës, i fuqizuar dhe promovues për shërbimin lëvizës dhe të drejtat e familjeve dhe fëmijët me aftësi të kufizuar.

## Neni 3: Deklarime dhe garanci reciproke

1. Kjo Marrëveshje bazohet në vizione të përbashkëta të World Vision Albania dhe Bashkisë Librazhd , që "Fëmijet me aftësi të kufizuar të përfitojnë përkudësjet maksimale nëpërmjet marrjes së shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencës shtëpiake dhe detyrimit që ka pushteti vendor ndaj shërbimeve për mirëqënien e fëmijëve në zonën e Librazhdit, sipas pikës 10 të Udhëzimit nr.597, date 22.12.2017 "Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencës shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuar".
2. World Vision Albania dhe Bashkia pranojnë se kjo Marrëveshje do të bazohet në parimet e zhvillimit të komunitetit dhe përfshirjes sociale dhe do të nxitet prej tyre. Ata përkushtohen që të krijojnë vullnet të



mirë, besim dhe mirëkuptim reciprok në çdo rast të mundshëm, si dhe të identifikojnë, dokumentojnë dhe zbatojnë praktika të mira partneriteti për të siguruar suksesin e projekteve të partneritetit.

3. World Vision Albania dhe Bashkia Librazhd bien dakord që do të kontribuojnë gjatë zbatimit të projektit duke siguruar ndryshime pozitive, afatgjata dhe të qëndrueshme në jetën e fëmijëve me aftesi të kufizuara në zonën e Librazhdit.
4. Secila Palë do të ketë personalisht përgjegjësinë për t'u përputhur me legjislacionin ose rregullat në fuqi kur të kryejë punë dhe veprimtari të tjera nën këtë Marrëveshje dhe nën çdo akt ligjor apo nënligjor të zbatueshëm ndaj secilës Pale.

#### **Neni 4: Përgjegjësitë e World Vision Albania nën këtë partneritet**

1. World Vision Albania duhet të bashkëpunojë me Bashkinë në të gjitha etapat e zbatimit të projektit, procedurat për rekrutimin, trajnimin, ecurinë e vizitave dhe informimin mbi elementët e angazhimit komunitar, menaxhimit të performancës dhe zgjidhjen e kontratës së punonjësve të ekipit lëvizës (specialisteve).
2. World Vision Albania ka përgjegjësinë e menaxhimit dhe supervizimit teknik të ekipit lëvizës (specialistëve) gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit.
3. World Vision Albania ka përgjegjësinë e respektimit të Dispozitave të Përgjithshme, ndarjes së detyrave, liste-prezencës dhe elementë të tjerë që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës. Referojuni për më shumë Aneksin 2.
4. World Vision Albania ka përgjegjësinë të sigurojë për Bashkinë informacionin e duhur në lidhje me pagesën mujore të specialistëve të ekipit lëvizës si dhe çështje dhe raportime të tjera që kanë të bëjnë me ecurinë e projektit.
5. World Vision Albania duhet të sigurojë infrastrukturen dhe logjistikën e nevojshme për zbatimin e këtij projekti siç janë makina dhe materialet e punës për ekipin lëvizës.
6. World Vision Albania është përcaktuese në pagat bruto të specialistëve dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, detyrim i punëdhënësit. Referoju për më shumë Aneksin 4.
7. World Vision Albania duhet të përmbushë të gjitha detyrimet financiare që lidhen me zbatimin e këtij projekti duke i transferuar Bashkisë Librazhd shumat përkatëse, për të cilat është rënë dakord, në kohën e duhur, sipas raporteve të ecurisë dhe parashikimeve të likuiditetit.
8. World Vision Albania duhet të dakordësohet me Bashkinë për hapësirën dhe vendqëndrimin e ekipit lëvizës, dosjeve dhe dokumentacionit të prodhuara nga ekipi.

#### **Neni 5: Përgjegjësitë e përgjithshme të Bashkisë Librazhd**

1. Të përdorë në mënyrë efektive burimet e siguruar nga World Vision Albania për zbatimin e projektit në përputhje me dokumentat e projekti, marrëveshjes dhe kontratës.
2. Të ndjekë procesin e rekrutimit të ekipit lëvizës (specialisteve) në përputhje me modalitetet e paracaktuara në bashkëpunim me World Vision Albania.
3. Të kryejë pagesën mujore dhe çdo detyrim tjetër financiar sipas ligjit të punësimit për çdo specialist të ekipit lëvizës nga fondi i transferuar nga World Vision Albania duke iu referuar kontratës së punësimit dhe evidencave të siguruar nga menaxheri i projektit "Tungjatjeta.. Jetë"
4. Bashkia Librazhd nuk ka përgjegjësi dhe detyrime financiare, me përjashtim të pagesës mujore të specialistëve, për zbatimin e projektit pasi me anë të kësaj marrëveshje World Vision Albania merr përsipër mbulimin e të gjitha detyrimeve financiare.
5. Bashkia do të lehtësojë zbatimin e projektin me kujdesin, efikasitetin, transparencën dhe zellin e kërkuar dhe me praktikën më të mira në sektor dhe në fushën e ndërhyrjes.
6. Bashkia do të përfshijë në strukturën e saj specialistët e ekipit lëvizës duke siguruar të njëjtën mbështetje nga ana e procedurave të brendshme, detyrimeve për pushimet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar si çdo staf tjetër i këtij institucioni por pa ndërhyrë në përshkrimin e punës të specialistëve bashkangjitur kësaj marrëveshje.



7. Bashkia në partneritet me World Vision Albania pranojnë të ulen në tryeza të përbashkëta gjatë proceseve të rishikimit të buxheteve dhe specifiku në çeljen e buxhetit social kur ti alokohet Bashkisë për të diskutuar mundësi ndarje kostosh të këtij shërbimi mes dy institucioneve bazuar në elementë të planeve lokale me fokus te fëmijët më në nevojë.

### **Neni 6: Kushti i Trasferimit të Fondeve**

1. Trasferimi i fondeve sipas kësaj Marrëveshje kryhet me kusht në kuptim të nenit 768 të Kodit Civil. Kushti i transferimit lidhet me përdorimin ekskluziv të Fondit vetëm për pagesën e specialistëve të ekipit lëvizës. ("Kushti")

2. Me qëllim vërtetimit e realizimit të "Kushtit":

2.1. Fondi do të transferohet tek Bashkia në formë 4 keste në formë parafinancimi dhe rimbussim të kombinuar, në bazë të Udhëzimeve të Partneritetit Financiar të World Vision Albania.

2.1.1. Kesti i parë: 840,240 ALL (lek), në datë 20 Prill 2018 në formë parafinancimi.

2.1.2. Kesti i dytë: 840,240 ALL (lek), në datë 20 Korrik 2018 në formë parafinancimi.

2.1.3. Kesti i tretë: 840,240 ALL (lek), në datë 19 Tetor 2018 në formë parafinancimi.

2.1.4. Kesti i katërt: 840,240 ALL (lek), në datë 21 Janar 2019 në formë parafinancimi.

2.2. Pas fillimit të projektit, shërbimit lëvizës, World Vision Albania do të paraqesë cdo muaj tek Bashkia dokumentat perkatëse për pagesën e specialistëve, sipas kërkesave të Bashkisë.

2.3. Në 16 Korrik 2018, 15 Tetor 2018, 15 Janar 2019 dhe 15 Prill 2019 Bashkia Librazhd do t'i paraqesë World Vision Albania informacion në lidhje me shpenzimin e fondit që vërtetojnë pagesat e specialistëve sipas ligjit të punësimit.

2.4. Dokumentat që vërtetojnë pagesat e specialistëve sipas ligjit shqiptar të vlefshme për vërtetimin e pagesave të specialistëve të World Vision Albania janë bordero; pagesa e sigurimeve; transferata bankare që vërteton pagesat e punonjësve.

2.5. Nëse një nga punonjësit nuk plotëson kushtet sipas marrëveshjes së punës apo jep dorëheqjen për arsye të ndryshme fondi i transferuar në Bashkinë Librazhd me këtë "Kusht" kthehet tek World Vision Albania.

2.6. Nëse projekti dështon për arsye madhore të cilat cojnë në prishje të marrëveshjes fondi i transferuar në dëgen e thesarit të Bashkisë Librazhd me këtë "Kusht" kthehet tek WORLD VISION ALBANIA.

3. Fondi do të transferohet në llogarinë e mëposhtme bankare të Bashkisë:

**Societe Generale Albania Banka Librazhd** : AL 1521334014000000000211665

**Dega e thesarit:** Bashkia Librazhd

**Kodi i pagesës:** 7207010

4. Komisionet bankare do të mbulohen nga World Vision Albania.

### **Neni 7: Procedurat e rekrutimit dhe të punësimit**

Bashkia Librazhd ndjekë procesin e rekrutimit dhe të punësimit të ekipit lëvizës (specialistëve) në përputhje me modalitetet e paracaktuara në bashkepunim me World Vision Albania të pershkruara në Dispozitatat e Pergjithshme.

**Neni 8: Taksat dhe detyrimet**

Bashkia Librazhd ka përgjegjësinë e pagesës së të gjitha taksave të zbatueshme në përputhje me Legjislacionin e punësimit në fuqi në Shqipëri për specialistet e ekipit lëvizës.

### **Neni 9: Publiciteti**



- 1- Nëse Bashkia Librazhd organizon ose përfshihet në aktivitete publiciteti të lidhura me këtë projekt, World Vision Albania duhet lajmëruar paraprakisht për këto aktivitete .
- 2- Bashkia Librazhd do të bashkëpunojë me World Vision Albania për çështje publiciteti duke përdorur logot dhe elemente vizibiliteti të të dy institucioneve.

#### **Neni 10: Auditi**

World Vision Albania ruan të drejtën të shqyrtojë gjithë të dhënat financiare me fonde të World Vision Albania, si dhe të kontrakttojë një audit të këtij projekti të zbatuar nga Bashkia Librazhd me fondet e vetë World Vision Albania.

#### **Neni 11: Përfundimi i marrëveshjes**

1. Projekti përfundon sipas afatit të përcaktuar në këtë marrëveshje.
2. World Vision Albania do të ketë të drejtën e përfundimit të marrëveshjes nëse Bashkia deshton në përmbushjen e Kushtit të vendosur në Nenin 6.
3. Kontrata mund të ndërpritet me paralajmërim paraprak prej 30 ditëve para datës së skadimit të secilit vit.
4. Palet do të njoftojnë me shkrim njëri-tjetrin nëse dëshirojnë që të vazhdojnë për vitin tjetër vijues, 30 ditë përpara skadimit të afati 12 muhor.

#### **Neni 12: Data e fillimit dhe fundit të marrëveshjes**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit World Vision Albania dhe Bashkia Librazhd dhe zgjat një vit.

#### **Neni 13: Konfidencialiteti**

Asnjëra palë nuk do të zbulojë informacione konfidenciale të palës tjetër në lidhje me programin, me këtë marrëveshje, pa miratimin paraprak me shkrim të palës në fjalë.

#### **Neni 14: Ligjet e zbatueshme dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Kjo marrëveshje u nënshtrohet ligjeve të Shqipërisë. Mosmarrëveshjet që, sipas mendimit të njërit prej palëve, nuk janë zgjidhur në mënyrë të kënaqshme, mund t'i kalohen gjykatës kompetente.

#### **Neni 15: Anekset**

Bashkalidhen si pjesë përbërëse dhe ë pandarë e kësaj Marrëveshje, dokumentat si më poshtë :


- Aneksi Nr. 1 : Koncepti i projektit "Tungjatjeta ....Jetë "
- Aneksi Nr. 2 : Dispozitata e Përgjithshme.
- Aneksi Nr. 3 : Përshkrimi i punës së specialistëve të ekipit lëvizës.
- Aneksi Nr. 4 : Buxheti i pageve dhe i kalimit të kësteve .

#### **BASHKIA LIBRAZHD**

Kastriot Gurra

Data:

Kastriot  
19.02.18



#### **World Vision Albania**

Eljona Elmazi

Data:

16.02.2018

